



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt,
Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 10 dhjetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe
për Parashtrime**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Nina Tavakoli

**Mbrojtësit Kujdestar të Bashkim
Smakajt**
Bas Martens

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Edwards
Xho Holms

Mbrojtësit Kujdestar të Fadil Fazliut
Mishiel Pesman

Mbrojtësit Kujdestar të Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) dhe (13) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), dhe rregullës 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi pjesërisht aktakuzën kundër Hashim Thaçi, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit (përkatësisht "z. Thaçi", "z. Smakaj", "z. Kilaj", "z. Fazliu", "z. Kuçi", dhe së bashku "të akuzuarit").² Po atë ditë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu lëshoi fletarrestimet për zotërinjtë Thaçi, Smakaj, Kilaj dhe Fazliu dhe një fletëthirrje për z. Kuçi.³

2. Më 2 dhjetor 2024, sipas urdhrit të Gjykatës së Procedurës Paraprake,⁴ Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi Aktakuzën e konfirmuar ("Aktakuza e Konfirmuar").⁵

3. Më 5 dhe 6 dhjetor 2024: (i) zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu u arrestuan nga ZPS-ja në Kosovë⁶ dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2024, konfidencial.

² KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës* ("Vendimi i Konfirmimit"), 29 nëntor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse* ("Vendimi për Arrestime dhe Fletëthirrje"), 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 313(g).

⁵ KSC-BC-2023-12, F00040, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 2 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale, e cila përmban Aktakuzën e Konfirmuar. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 dhjetor 2024, [F00055/A01](#).

⁶ KSC-BC-2023-12, F00042, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Bashkim Smakajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2023, konfidencial; F00043, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Isni Kilajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2023, konfidencial; F00045, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Fadil Fazliut sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2023, konfidencial.

të Specializuara ("DHS"), në Hagë, Holandë;⁷ (ii) zotit Kuçi iu dorëzua fletëthirrja;⁸ dhe (iii) zotit Thaçi iu dorëzua fletarrestimi në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁹

4. Më 8 dhe 9 dhjetor 2024, u mbajtën seancat e paraqitjes së parë ("paraqitja e parë") të të akuzuarve¹⁰ dhe palët deklaruan se do të ishin të pranishme në konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes më 17 dhjetor 2024, ora 14:00.¹¹

⁷ KSC-BC-2023-12, F00056, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00057, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Fadil Fazliut në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00058, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Bashkim Smakajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00065, Administratorja, *Raport mbi Arrestimin dhe Transferimin e Fadil Fazliut në Objektin e Paraburgimit*, 7 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00066, Administratorja, *Raport mbi Arrestimin dhe Transferimin e Bashkim Smakaj në Objektin e Paraburgimit*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, 7 dhjetor 2024, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00067, Administratorja, *Raport mbi Arrestimin dhe Transferimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit*, 8 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2023-12, F00046, Administratorja, *Njoftim mbi Dorëzimin e Fletëthirrjes për Paraqitje për Hajredin Kuçin*, 5 dhjetor 2024, konfidencial; F00068, Administratorja, *Raport mbi Dorëzimin e Fletëthirrjes për Paraqitje për Hajredin Kuçin*, 8 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00048, Administratorja, *Njoftim mbi Dorëzimin e Fletarrestimit për Hashim Thaçin sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, konfidencial; F00064, Administratorja, *Raport mbi Dorëzimin e Fletarrestimit për Hashim Thaçin*, 7 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00059, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 dhjetor 2024, publik; F00063, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Ricaktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Isni Kilajt*, 7 dhjetor 2024, publik.

¹¹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake kujton se, në paraqitjen e parë të z. Thaçi, mbrojtësja Tavakoli deklaroi se nuk do të kishte mundësi të ishte e pranishme në konferencën mbi ecurinë e çështjes të martën, 17 dhjetor 2024, por se z. Thaçi mund të përfaqësohej nga mbrojtësi Luka Mishetiq, i cili, pas emërimit, do të ishte në gjendje të merrte pjesë përmes videokonferencës (*shih* KSC-BC-2023-12, Transkripti i Paraqitjes së Parë, 8 dhjetor 2024, faqja 14, rreshtat 7-15). Gjatë paraqitjes së parë të z. Kuçi, mbrojtësi Admiral u shpreh se do të mund të ishte i pranishëm në konferencën mbi ecurinë e çështjes më 17 dhjetor 2024 përmes videokonferencës (*shih* KSC-BC-2023-12, Transkripti i Paraqitjes së Parë, 9 dhjetor 2024, faqja 81, rreshtat 5-8).

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. KONFERENCA MBI ECURINË E ÇËSHTJES

5. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit, ndër të tjera, për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; dhe (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë përgatitjet e nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë.

B. NXJERRJA E MATERIALEVE

6. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, të gjitha provat ose faktet materiale dhe relevante që i posedon ZPS-ja, të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, vihen në dispozicion të të akuzuarit para fillimit të gjykimit dhe gjatë tij, vetëm me kufizime rreptësisht të domosdoshme dhe me garancitë mbrojtëse kompensuese të nevojshme.

7. Në pajtim me rregullën 102(1)(a) të Rregullores, dhe në varësi të rregullave 105, 107, dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes, dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, sa më shpejt që të jetë e mundshme, por të paktën brenda 30 ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit, materialet mbështetëse të aktakuzës së konfirmuar, si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit.

8. Në pajtim me rregullën 102(1)(b) të Rregullores, brenda afatit të përcaktuar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë përpara hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes materialet vijuese: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, në një gjuhë që i

akuzuari kupton dhe flet; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet apo transkriptet që Prokurori i Specializuar synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) provat materiale që Prokurori i Specializuar synon t'i paraqesë në gjykim.

9. Në pajtim me rregullat 102(2) dhe (4) të Rregullores, çdo deklaratë e dëshmitarëve shtesë të ZPS-së që nuk i është bërë e njohur Mbrojtjes brenda afatit 30-ditor përpara hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar dhe që ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, i vihen në dispozicion Mbrojtjes sa më shpejt që të jetë e mundur, në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet, së bashku me arsyet për nxjerrjen e vonuar të materialeve. Nxjerrja e këtyre materialeve finalizohet gjatë fazës së procedurës paraprake.

10. Në pajtim me rregullën 102(3) të Rregullores, ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim. Me kërkesë të Mbrojtjes, ZPS-ja vë në dispozicion pa vonesë çdo deklaratë, dokument dhe fotografi dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e ZPS-së, që Mbrojtja i konsideron thelbësore për përgatitjen e vet ose që i janë marrë apo i përkisnin të akuzuarit.

11. Në pajtim me rregullën 103 të Rregullores dhe në varësi të rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes çdo informacion për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të ZPS-së, sapo një informacion i tillë të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së.

C. MATERIALI I MBROJTUR DHE REDAKTIMET

12. Në pajtim me nenin 58 të Ligjit dhe rregullën 107(1)-(2) të Rregullores, ZPS-ja i bën Panelit kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* për t'u liruar, tërësisht ose pjesërisht, nga detyrimi sipas rregullave 102 dhe 103 të Rregullores për nxjerrjen

e materialit fillestar në qoftë se informacioni që ZPS-ja ka nën ruajtje ose kontroll, i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja dhe për të cilin nuk ka marrë pëlqimin e dhënësit për ta nxjerrë.

13. Në pajtim me nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullën 80(1) të Rregullores, Paneli mund të urdhërojë masa të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së një dëshmitari.

14. Në pajtim me rregullën 80(4)(a)(i)-(iii) dhe (d) të Rregullores, këto masa mund të përfshijnë fshirjen e emrave dhe të dhënave identifikuese për parandalimin e nxjerrjes për të akuzuarin dhe/ose publikun, aty ku është e nevojshme, të identitetit ose vendndodhjes së një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në proces ose një personi të lidhur familjarisht ose në një mënyrë tjetër me ta.

15. Në pajtim me rregullën 108(1) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë trupit gjykues kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* për mosnxjerrjen e informacionit përkatës, në tërësi ose pjesërisht, kur nxjerrja e këtij informacioni mundet që, ndër të tjera, të cenojë hetimet aktuale ose të ardhshme, ose të shkaktojë rrezik të rëndë për sigurinë e një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në proces ose anëtarëve të familjeve të tyre. Në pajtim me rregullën 108(6) të Rregullores, e njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* dhe për Mbrojtjen.

D. PRANIMI I FAJËSISË

16. Në pajtim me rregullën 92(2)(c) të Rregullores, në paraqitjen e parë, gjykatësi i procedurës paraprake informon të akuzuarin se, brenda tridhjetë (30) ditësh pas paraqitjes së parë, atij ose asaj do t'i kërkohet të deklarojë nëse është fajtor ose i pafajshëm për çdo akuzë ose, në qoftë se dëshiron, i akuzuari mund të deklarojë menjëherë nëse është fajtor ose i pafajshëm.

III. DISKUTIM

17. Pas paraqitjes së parë së të akuzuarve, procesi i nxjerrjes së provave dhe materialeve nga ZPS-ja për Mbrojtjen pritet të fillojë menjëherë, në përputhje me kornizën ligjore të sipërpërmendur dhe në mënyrën dhe afatet e përcaktuara nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake. Duke mbajtur parasysh fushëveprimin e akuzave, përfshirë edhe pretendimet bazë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e prirë të ndjekë një ritëm të shpejtë me qëllim përfundimin e fazës paraprake në kohën e duhur. Për të mundësuar këtë proces të nxjerrjes së materialeve në të mirë të palëve, dhe veçanërisht të Mbrojtjes, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të mbledhë një konferencë mbi ecurinë e çështjes, siç parashihet nga rregulla 96(1) e Rregullores, me qëllim marrjen e parashtrimeve lidhur, ndër të tjera, me nxjerrjen e materialeve, sistemin e redaktimit që do të miratohet në këtë proces, si dhe çdo temë tjetër relevante që lidhet me të, si të gjykohet e nevojshme nga palët. Duke marrë parasysh disponueshmërinë e palëve sipas deklarimeve të tyre gjatë paraqitjes së parë,¹² Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendos të mbajë një konferencë për ecurinë e çështjes **të martën, 17 dhjetor 2024, në orën 14:00.**

18. Gjykatësja e Procedurës Paraprake udhëzon palët dhe Zyrën Administrative të bëjnë parashtrime me shkrim për pikat e rendit të ditës të konferencës për ecurinë e çështjes, bashkëngjitur këtij urdhri ("Shtojca"), dhe për të tjera tema relevante që ata konsiderojnë të nevojshme. Në rastet kur informacioni nuk mund të ndahet me palët për qëllime konfidencialiteti dhe mbrojtjeje, parashtrimet mund të bëhen me shkrim *ex parte*. Informacioni i dhënë do të ndihmojë Gjykatësen e Procedurës Paraprake në formulimin e vendimit të

¹² Shih më lart, para. 4.

ardhshëm kornizë për nxjerrjen e provave dhe çështje të lidhura me të, duke përfshirë edhe afatet për nxjerrjen e tyre.

19. Në lidhje me këtë, me qëllim shpejtimin e procesit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e konsideron të nevojshme marrjen e parashtrimeve nga palët për vendosjen e një sistemi redaktimi efikas, të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm.¹³ Për këtë qëllim, siç specifikohet në pikën 7 të Shtojcës, Gjykatësja e Procedurës Paraprake u kërkon palëve të bëjnë parashtrime me shkrim lidhur me sistemin e redaktimit të informacionit dhe të provave që do të zbatohet në këtë çështje, të ngjashëm me atë që përcaktohet në Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të lidhura me Të në çështjen KSC-BC-2023-10, që është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në procese të ndryshme para kësaj gjykate.¹⁴ Këto parashtrime do t'i shërbejnë Gjykatësës së Procedurës Paraprake në miratimin e sistemit të redaktimit, i cili do të sigurojë efikasitet të procesit të nxjerrjes së informacionit duke vendosur një barazpeshë midis detyrës për mbrojtjen e interesave të viktimave dhe dëshmitarëve nga njëra anë dhe duke respektuar të drejtat e të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit nga ana tjetër.

20. Duke mbajtur parasysh se të akuzuarit akuzohen për tre krime të ndryshme, që përfshijnë forma të ndryshme të përgjegjësisë penale, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson gjithashtu se nxjerrja e provave duhet të bëhet në mënyrë të organizuar dhe efikase, duke shfrytëzuar

¹³ Shih ngjashëm, KSC-BC-2023-10, F00076/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To* ("Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen 10"), 24 tetor 2023, publik, para. 97.

¹⁴ Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen 10, para. 92-110; shih gjithashtu, KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 30 prill 2021, publik, para. 75-91; KSC-BC-2020-07, F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 22 janar 2021, publik, para. 68-84; KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 23 nëntor 2020, publik, para. 82-98; KSC-BC-2020-05, F00034, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje në lidhje me To*, 9 tetor 2020, publik, para. 73-89.

plotësisht sistemin elektronik ekzistues të krijuar për nxjerrjen e informacionit.¹⁵ Procesi i organizuar i nxjerrjes së materialeve do t'i lejojë Mbrojtjes të përgatitet si duhet dhe shpejt për proceset e ardhshme, do ta bëjë procesin më produktiv dhe më efikas dhe, në fund, do t'i mundësojë Trupit Gjykses t'i marrë provat në mënyrë të rregullt. Kjo vlen veçanërisht për çështjen në fjalë, ku procedura paraprake duhet të mbyllet në kohën e duhur. Për këtë qëllim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e konsideron të nevojshme marrjen e parashtrimeve të palëve lidhur me miratimin e një nënkategorizimi specifik për këtë çështje në sistemin elektronik *Legal Workflow*,¹⁶ siç përcaktohet në pikën 8 të Shtojcës.

21. Rikujtojmë se, megjithëse të akuzuarit kanë të drejtë të jenë të pranishëm fizikisht, sipas rregullës 96(2) të Rregullores, duke marrë parasysh natyrën teknike të temave që do të diskutohen, konferenca për ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarve dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësve nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësve dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarve nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarve me praninë e mbrojtësve ose pjesëmarrjes së mbrojtësve nëpërmjet videokonferencës. Gjithsesi, për këto masa nevojitet dhënia e pëlqimit me shkrim nga të akuzuarit, pas këshillimit me mbrojtësit e tyre, në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores.

22. Nëse zotërinjtë Thaçi, Smakaj, Fazliu dhe Kilaj, të cilët janë në paraburgim, dëshirojnë të marrin pjesë në konferencat e ardhshme për ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës, ata duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara në rregullën 96(2) të Rregullores dhe në Udhëzuesin e Punës së Administratores për videolidhjet (KSC-BD-23/COR), mjaftueshëm në kohë që Administratorja të marrë

¹⁵ Shih rregullën 109(a) të Rregullores; Njësia për Administrimin e Gjykatës, *Udhëzues për Përdorimin e Sistemit Elektronik Legal Workflow të Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 15 prill 2021, *limité*, gjendet në <<https://kosmos.scp-ks.org/JSD/CMU/Documents/20210415-KSCLW-UserGuide-v1.1-LIMITE.pdf>>.

¹⁶ Shih për ngjashmëri, KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të lidhura me Të*, 12 mars 2021, publik, para. 19-20; KSC-BC-2020-04, F00024, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 20 prill 2023, publik, para. 21.

masat e përshtatshme, duke përfshirë edhe informimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake. Për këtë qëllim, të paktën dy (2) ditë para seancës përkatëse duhet të dorëzohet për protokollim një njoftim me shkrim.¹⁷

23. Z. Kuçi, i cili nuk është në paraburgim, por vazhdon të jetë i lirë në Kosovë, ka detyrimin të jetë i pranishëm në çdo seancë gjyqësore të planifikuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake.¹⁸ Pavarësisht nga kjo, në kuadrin e konferencës për ecurinë e çështjes, Gjykatësja e Procedurës Paraprake sqaron se opsionet e përcaktuara në paragrafin 21 më lart vlejnë edhe për z. Kuçi. Në qoftë se z. Kuçi dëshiron të jetë i pranishëm në konferencat e ardhshme për ecurinë e çështjes nga Kosova përmes videokonferencës, edhe ai duhet të përmbushë kriteret e rregullës 96(2) të Rregullores dhe Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për videolidhjet (KSC-BD-23/COR). Për këtë qëllim, ai duhet të dorëzojë një njoftim me shkrim për protokollim të paktën pesë (5) ditë pune para çdo konference të tillë për ecurinë e çështjes, në mënyrë që Administratorja të mund të ndërmarrë hapat e duhur, duke përfshirë edhe informimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake.

24. Mbrojtësit e çdo të akuzuari që duan të marrin pjesë në konferencat e ardhshme për ecurinë e çështjes pa prani fizike duhet të njoftojnë Zyrën Administrative brenda dy (2) ditësh pune, në mënyrë që Administratorja të mund të ndërmarrë hapat e duhur, duke përfshirë edhe informimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake.

¹⁷ Për seancat gjyqësore të së hënës, kjo nënkupton njoftimin të enjten në mëngjes. Për seancat gjyqësore të së martës, kjo nënkupton njoftimin të premten në mëngjes. Kjo i lejon kohë mjaftueshëm Njësisë së Paraburgimit për të njoftuar autoritetet përkatëse në shtetin pritës lidhur me transportin.

¹⁸ Në rast se z. Kuçi nuk paraqitet në seancë gjyqësore, pa autorizimin e DHS-së dhe pa arsye të vlefshme, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të lëshojë fletarrestim dhe do të urdhërojë paraburgimin e z. Kuçi, siç përcaktohet në rregullën 68(3) të Rregullores. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Arrestimin dhe Fletëthirrjen para. 101.

25. Së fundi, duke marrë shënim se zotërinjtë Thaçi dhe Smakaj nuk kanë bërë deklarinimin e fajësisë gjatë paraqitjes së tyre të parë, sipas rregullës 92(2)(c) të Rregullores, ata ftohen që, në rast se dëshirojnë, të pranojnë fajësinë ose të deklarojnë të pafajshëm për secilën nga akuzat kundër tyre në Aktakuzën e Konfirmuar, gjatë konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes, më 17 dhjetor 2024. Në qoftë se zotërinjtë Thaçi dhe Smakaj vendosin të mos pranojnë fajësinë apo të deklarojnë të pafajshëm në atë moment, Gjykatësja e Procedurës Paraprake synon t'i ftojë të akuzuarit t'i bëjnë zyrtarisht deklaratat zyrtare, në qoftë se do të kenë, deri më 7 janar 2025. Në qoftë se zotërinjtë Thaçi dhe Smakaj vendosin të mos e shfrytëzojnë këtë të drejtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të bëjë në emër të tyre deklarinimin se janë të pafajshëm dhe do të procedojë sipas rregullës 95 të Rregullores.

IV. VENDIM

26. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- (a) **VENDOS** të mbajë konferencën mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së, Mbrojtjes dhe Zyrës Administrative, **të martën, 17 dhjetor 2024, në orën 14:00;**
- (b) **URDHËRON** z. Kuçi të paraqitet në konferencën mbi ecurinë e çështjes më 17 dhjetor 2024 dhe në çdo konferencë mbi ecurinë e çështjes në të ardhmen, në qoftë se ai vendos të mos shfrytëzojë opsionet e përcaktuara në paragrafin 23 të këtij urdhri;
- (c) **UDHËZON** palët dhe Zyrën Administrative të paraqesin parashtrime me shkrim për pikat e renditura në Shtojcë, sipas rastit, ose për të tjera tema relevante si ta gjykojnë të nevojshme, siç përcaktohet në paragrafët 18-20 të këtij urdhri, deri (i) **të enjten, 12 dhjetor 2024, në**

orën 12:00 për ZPS-në dhe Zyrën Administrative, dhe (ii) të premten, 13 dhjetor 2024, në orën 12:00 për Mbrojtjen; dhe

- (d) **FTON** zotërinjtë Thaçi dhe Smakaj të pranojnë fajësinë ose të deklarojnë të pafajshëm për secilën nga akuzat kundër tyre në Aktakuzën e Konfirmuar (KSC-BC-2023-12, F00040/A01) në konferencën e ardhshme mbi ecurinë e çështjes, siç përcaktohet në paragrafin 25 të këtij urdhri.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E martë, 10 dhjetor 2024

Në Hagë, Holandë.